



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Vendimi. nr.01/977 / Dt. 01/09 /2018

Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka " Gjilan, në mbledhjen e vet të mbajtur më 25.7.2018, bazuar në nenin 49, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, të Statutit të Përkohshëm të Universitetit, miraton këtë:

RREGULLORE

MBI PROCEDURAT E ANGAZHIMIT TË BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM-ME HONORAR NË UNIVERSITETIN PUBLIK "KADRI ZEKA" GJILAN

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Kjo Rregullore është hartuar duke u bazuar në dispozitat e Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, Ligjit mbi Arsimin e Lartë nr. 04/L-037, UA të MPMS nr. 07/2017 dhe Statutin e Përkohshëm të Universitetit.

Neni 2

Kjo Rregullore ka për qëllim të rregullojë procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorve të jashtëm-me honorar për mbajtjen e ligjëratave, ushtrimeve, kolokuiumeve, konsultimeve, si dhe mentorimeve, sipas nevojës së njësisë akademike.



Neni 3

Periudha e angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm bëhet për një semester, përkatësisht dy semestra brenda të njëjtit vit akademik.

3.1 Kontratat për angazhim lidhen prej datës 1 tetor deri më 15 shkurt për semestrin dimëror dhe prej datës 15 shkurt deri më 30 qershor për semestrin veror të vitit përkatës akademik ose prej datë 1 tetor deri më 30 qershor (për një vit akademik).

3.2 I/e angazguari/ja ka për obligim që në kuadër të kontratës t'i kryejtë të gjitha obligimet që dalin nga neni 2 i kësaj rregulloreje.

3.3 I/e angazguari/ja ka për obligim që të mbajë provimet gjatë tërë vitit akademik.

Neni 4

Procedurat e angazhimit bëhen në mënyrë transparente nëpërmjet shpalljes së konkursit publik.

Neni 5

Përfshirja nga neni 4 bëhet për kategoritë, si në vijim:

- Personelin akademik në marrëdhënie të rregullt pune;
- Personelin akademik, i cili në momentin e plotësimit të moshës së pensionimit ka qenë në marrëdhënie të rregullt pune në universitetet publike (këshilli i fakultetit nxjerrë vendim për angazhimin e kësaj kategorie për vitin përkatës akademik).
- Profesorët, profesorët vizitorë nga vendet e tjera, të punësuar në universitetet respektive me të cilët UKZ ka marrëveshje bashkëpunimi (vendimin për angazhimin e kësaj kategorie e bie Senati i UKZ-së).

PROCEDURAT E SHPALLJES SË KONKURSIT

Neni 6

Shpallja e konkursit bëhet pas miratimit të propozimeve të këshillave të fakulteteve nga Senati.



Neni 7

Rektori, me një arsyetim të bazuar në konsultim me dekanin, mund t'i propozojë Senatit shpalljen e konkursit për angazhim të personelit akademik, pa vendimin e Këshillit të Fakultetit.

Neni 8

Konkursi duhet t'i referohet dispozitave të Ligjit mbi Arsimin e Lartë, Ligjit të Punës dhe kësaj rregulloreje:

- Konkursi shpallet në uebfaqen zyrtare të Universitetit;
- Kohëzgjatja e konkursit është 15 ditë kalendarike, nga dita e shpalljes;
- Kandidatët, të cilët aplikojnë, duhet t'i dorëzojnë të gjitha dokumentet e kërkuara në konkurs, në kopje fizike, të noterizuara dhe në formë elektronike;
- Diplomat dhe gradat shkencore, të fituara jashtë vendit, duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-I, para datës së mbylljes së konkursit;
- Dokumnetacioni i dorëzuar në konkurs nuk kthehet.

KOMISIONET VLERËSUESE

Neni 9

Brenda 7 (shtatë) ditëve, pas hapjes së konkursit, dekani i fakultetit thërret mbledhjen e Këshillit të Fakultetit, në të cilën merret vendim për formimin e komisioneve vlerësuese.

Vendimi i Këshillit të Fakultetit për formimin e Komisioneve vlerësuese i dërgohet Senatit për miratim.

Neni 10

Komisioni vlerësues përbëhet nga 3 (tre) anëtarë nga radha e profesorëve me thirrje akademike nga universitetet publike dhe i njëjti duhet të ketë kredibilitet profesional dhe akademik.



Anëtarët e komisionit vlerësues kompenzohen sipas rregullores në fuqi.

Neni 11

Komisioni vlerësues, pas përmbylljes së afatit të konkursit ka për detyrë të thërras mbledhjen e komisionit dhe në koordinim me ta në afat jo më shumë se 10 ditësh të hartojë raportin e vlerësimit, duke pasur parasysh këto obligime:

- Këshilli i Fakultetit shqyrton raportet vlerësuese, brenda 3 ditësh, pas marrjes së raporteve vlerësuese dhe e publikon vendimin në kohëzgjatje prej tre ditësh;
- Komisioni ka për obligim të shqyrtojë të gjitha aplikacionet e paraqitura për lëndët përkatëse. Komisioni vlerësues harton raportin vetëm për kandidatët që i plotësojnë kushtet formal juridike sipas konkursit.
- Komisioni duhet të paraqes të gjitha faktet relevante për të gjithë kandidatët, duke i paraqitur ato në mënyrë tabelare në formularët standard të UKZ-së;
- Komisioni mban përgjegjësi ligjore, disiplinore dhe morale për vlerësimin e të dhënave në raportin e vlerësimit.
- Komisioni mban procesverbal, lidhur me trajtimin e kërkesave për angazhim për të gjithë kandidatët e paraqitur në konkurs.

KUSHTET E ANGAZHIMIT

Neni 12

Personeli i angazhuar, në cilësinë e bashkëpunëtorit të jashtëm, nuk mund të marrë thirrje akademike.

Neni 13

Për pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm - me honorar, kandidatët duhet t'i plotësojnë këto kushte:

13.1 Për ligjërues ose professor:

- Të kenë gradën shkencore Dr. nga lëmi përkatës (në lëndët e arteve figurative dhe të muzikës grada ekuivalente me të);



- Të kenë përvojë pune si ligjërues apo profesor;
- Në rast se asnjëri nga kandidatët nuk i plotëson kushtet, sipas pikave 1, 2 dhe 3, atëherë përzgjedhet kandidati me gradën më të lartë shkencore;
- Në mungesë të kandidatëve me gradën e doktorit të shkencave (Dr. Sc.) dhe nëse brenda njësisë akademike nuk mund të sigurohet kandidati me gradën e magjistratit (Mr. Sc.) ose masterit (MA), i cili do të mund të angazhohej për mbajtjen e ligjëratave në lëndën e caktuar, në përputhje me Statutin, për pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm për ligjërata në nivelin baçelor mund të angazhohet kandidati me gradën Mr. Sc. ose MA, duke i dhënë përparësi kandidatit që ka të regjistruara studimet e doktoratës. Për të njëjtin Këshilli i Fakultetit nxjerr vendim për t'ia besuar lëndën nën përkujdesjen e një profesori në marrëdhënie të rregullt pune në fushën përkatëse.

13.2 Për bashkëpunëtor për mbajtjen e ushtrimeve:

- Të kenë përfunduar studimet e rregullta baçelor dhe master apo ekuivalent në lëmin përkatës;
- Të kenë notën mesatare jo më pak se 8 në të dy nivelet e studimit (veç e veç) ;
- Studimet themelore dhe ato master të kenë minimum 300 ECTS
- Kandidatët me gradën më të ultë se master nuk mund të angazhohen për mbajtjen e ushtrimeve.

13.3 Në UKZ nuk mund të angazhohen kandidatët të cilët kanë më shumë se një angazhim në marrëdhënie të rregullt pune apo me honorar në institucionet publike apo private me pagë primare apo sekondare

13.4 Në UKZ nuk do të lejohet angazhimi i kandidatëve, brenda një njësie akademike, nëse brenda saj kanë në marrëdhënie të rregullt pune apo të angazhuar familjar të ngushtë (në relacion prind-fëmijë, vëlla-motër dhe anasjelltas, si dhe vëlla-vëlla apo motër-motër, bashkëshort-bashkëshorte dhe anasjelltas).

E DREJTA E ANKESËS

Neni 14

Kandidatët e pakënaqur, me vendimin e Këshillit të Fakultetit, kanë të drejtë ankese, në afatin prej 3 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit, nga ana e Këshillit të Fakultetit.

Neni 15

Komisioni i ankesave, i cili formohet nga Këshilli i Fakultetit dhe i cili përbëhet nga 3 antarë, pas përfundimit të afatit të ankesave do të përpilojë raportin dhe propozimet përkatëse dhe të njëjtin t'ia dorëzojë Këshillit të Fakultetit. Raportin duhet ta bëjë brenda 3 ditëve.

Neni 16

Këshilli i Fakultetit, në afatin prej 3 ditësh, nga marrja e raportit duhet të shqyrtojë propozimet e Komisionit të ankesave dhe të vendosë për miratimin apo refuzimin e tyre

Neni 17

Vendimin përfundimtar për personelin e angazhuar e merr Senati.

Senati e mban mbledhjen brenda 7 ditëve, pas miratimit të raporteve përfundimtare dhe të ankesave nga këshillat e fakulteteve.

Vendimi i Senatit është përfundimtar në nivel të UKZ-së

Neni 18

Pas miratimit të propozimeve të këshillave të fakulteteve nga Senati i UKZsë, fakultetet përgatisin listat e personelit të angazhuar dhe i dorëzojnë në Zyren për çështje akademike për përgatitjen e kontratave për nënshkrim, nga rektori i UKZ-së.

TË DREJTAT DHE OBLIGIMET

Neni 19

Angazhimi, sipas kësaj rregulloreje nuk nënkupton themelimin e marrëdhënies së rregullt të punës.



Neni 20

Kandidatëve të angazhuar, në cilësinë e bashkëpunëtorit të jashtëm, nuk iu takon e drejta në pushim vjetor dhe as kompensim të përvojës së punës.

Neni 21

Kandidatët e angazhuar bartin përgjegjësi ligjore për mënyrën e shfrytëzimit të aseteve të UKZ-së.

Neni 22

Kjo rregullore hynë në fuqi, nga dita e miratimit, nga Senati i Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan.



Kryesuesi i Senatit të UKZ-së

A handwritten signature in blue ink, which appears to be 'Bajram Kosumi', is written over a horizontal line.

Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi, Rektor